

Thirrje publike për shprehje interesi të kompanive për bashkëpunim me Qendra e Inovacionit Digjital (QID) INOFEIT dhe për vlerësimin e potencialit për ngritjen e shkallës së maturimit digjital

Qendra e Inovacionit Digjital (QID) INOFEIT, në bashkëpunim me Programin Zvicerian për rritjen e punësueshmërisë së tregut (Increasing Market Employability- IME) dhe Fondit të Inovacioneve dhe Zhvillimit Teknologjik (FIZHT), shpall thirrje publike për shprehje të interesit të kompanive për bashkëpunim me QID dhe për vlerësimin e potencialit për ngritjen e shkallës së maturimit digjital. Në thirrje mund të marrin pjesë kompanitë mikro, të vogla dhe të mesme:

- të regjistruara në përputhje me Ligjin e shoqërive tregtare dhe të regjistruara në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- me shumicë pronësie maqedonase (me 50,1% ose më shumë);
- të hyrat vjetore të shoqërisë nuk duhet të tejkalojnë 10.000.00 (dhjetë milionë) euro në dy vjetët e fundit fiskalë, sipas raporteve financiare;
- të jetë shoqëri me një maksimum prej 250 punonjësish;

Aplikantët e thirrjes duhet të jenë nga domenët jo-TIK të mbuluar me specializim inteligjent, pra nga fusha e agrobiznesit, industrisë 4,0, materialet dhe ndërtesat e zgjuara, turizmi dhe energjetika të cilat posedojnë të paktën **nivelin e shkallës 2 të maturimit digjital***. Kompanitë e zgjedhura nga thirrja do të marrin raportin që përmban:

- analizë të detajuar të nivelit aktual të maturimit digjital në përputhje me metodologjinë evropiane;
- analizë të detajuar të potencialit për transformimin e ardhshëm digjital dhe rritjen e ardhshme;
- veçim të teknologjive/pajisjeve kryesore të nevojshme për transformimin digjital dhe ngritjen e nivelit të maturimit digjital të shkallës së përmendur më sipër.

Kohëzgjatja e vlerësimit nga ekipi ekspertëve të QID INOFEIT **për kompani është nga 2 deri në 4 ditë** (në varësi të sektorit, madhësisë së kompanisë dhe shkallës së maturimit digjital). Kostoja e shërbimit është **500 euro në ditë**, në kundërvlerë të denarit, për kompani. Numri i ditëve të nevojshme përcaktohet para fillimit të procesit. **Programi IME do të bashkëfinancojë deri në 50% të shpenzimeve të vlerësimit, pasi të jetë bërë pagesa nga kompania. Nëse kompania është në pronësi ose menaxhohet (udhëheqës) nga një grua ose person deri në moshën 29 vjeç, Programi IME do të mbulojë 60% të kostove të vlerësimit. Nëse kompania është në pronësi ose menaxhohet nga një grua deri në moshën 29 vjeçe, Programi IME do të mbulojë 70% të kostove të vlerësimit.**

Të gjithë kompanitë e interesuara mund të aplikojnë duke dërguar aplikacionin e plotësuar sipas [shembullit](#) në adresën e e-mailit innofeit@feit.ukim.edu.mk. QID INOFEIT do të paraqesë ofertë të përshtatshme për kohëzgjatjen dhe shumën e shërbimit për çdo kompani që do të aplikojë jo më vonë se 3 ditë pas pranimit të aplikimit. Kompania duhet do të duhet të deklarohet për pranimin e ofertës dhe të nënshkruajë marrëveshje për bashkëpunimin jo më vonë se 2 ditë pas pranimit të ofertës nga QID INOFEIT.

Thirrja është e hapur deri më 28 tetor 2022.

Pas përfundimit të thirrjes publike për vlerësimin e potencialit për ngritjen e shkallës së maturimit digjital, FIZHT dhe Programi IME do të publikojnë thirrje të hapur – sfidë tematike për përkrahje dhe bashkëfinancim në zhvillimin dhe implementimin e teknologjive/veglave thelbësore inovative dhe transformimin digjital në të cilën mund të marrin pjesë të gjitha kompanitë e interesuara. Analiza dhe vlerësimi i potencialit për ngritjen e shkallës së maturimit digjital nga QID INOFEIT do të sigurojë vizion të qartë për drejtimit e zhvillimit të ardhshëm të kompanisë dhe do të lehtësojë përgatitjen e aplikacionit të thirrjes së hapur – sfidën tematike të FIZHT-së dhe Programit IME që do të vijë.

* Shkalla e maturimit digjital i një kompanie mund të gjendet në një nga nivelet e mëposhtme:

- **0 – Puna manuale:** përdorim i kufizuar i sistemeve digjitale në kompani, domethënë metoda më e shpeshtë e mbledhjes së të dhënave është në mënyrë manuale;
- **1 – Kompjuterizimi:** përdorimi i sistemeve digjitale (kompjuterë, serverë, baza dhe të ngjashme) të cilat ruajnë informacione të rëndësishme nga punët e përditshme të kompanisë, por që nuk janë të lidhura me njëra-tjetrën (edhe pse mund të jenë të lidhura me rrjetin e internetit);
- **2 – Lidhja:** sistemet digjitale në kompani janë të lidhura me njëri-tjetrin dhe shkëmbejnë të dhëna për të ofruar aplikacioneve të biznesit dhe softuerëve (si psh. sistemi ERP, DMS dhe të ngjashme) informacione të rëndësishme, por jo në kohë reale;
- **3 – Monitorimi:** punët e kompanisë monitorohen në vazhdimësi (përmes të ashtuquajturave panele (dashboards) dhe të dhënat e mëparshme për proceset e rëndësishme të biznesit sigurohen në kohë reale (më shpesh duke dhënë të dhëna sensoriale);
- **4 – Kuptimi:** të dhënat e mbledhura analizohen dhe interpretohen për të ofruar kuptim shtesë të proceseve të biznesit (e ashtuquajturat analitike e të të dhënave përmes veglave të përshtatshme);
- **5 – Parashikimi:** simulimi i skenarëve të ardhshëm duke përdorur sasi të madhe të të dhënave të akumuluar momentalisht, me qëllim të parandalimit të situatave të mundshme në të ardhmen (si p.sh.: ndërpreje ose rënie);
- **6 – Përshtatshmëria:** të gjitha të dhënat dhe parashikimet janë parametra hyrës në proceset e biznesit duke mundësuar marrjen automatike të vendimeve dhe veprime automatike që optimizojnë vazhdimisht proceset e biznesit.